




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin fiskal 2019



Prishtinë, maj 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000)¹ si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” për vitin fiskal 2019, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Samir Zymberi, *Udhëheqës i auditimit*

Donjetë Dreshaj, *Udhëheqës i ekipit*

Vjosë Bojku, *Anëtar i ekipit*

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

<http://zka-rks.org>

-
- 1 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.
 - 2 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.
 - 3 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.
 - 4 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	1
Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim	2
1.Hyrje.....	3
Motivi i auditimit	5
Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit	5
2.Përshkrimi i fushës së auditimit	7
3.Gjetjet e auditimit.....	9
3.1. Procesi i prioritizimit të projekteve në të cilat është investuar	10
3.2. Menaxhimi i projekteve në raport me kërkesat e marrëveshjes	12
3.3. Granti i Performancës Komunale dhe rezultatet e synuara	15
3.4. Krahasimet ndërmjet burimeve të financimit të GPK-së nga HSIK/DEMOS-i dhe MPL-ja	20
4.Konkluzionet	21
5.Rekomandimet	22
Shtojca 1: Detajet financiare dhe të kohëzgjatjes së marrëveshjeve për GPK-në.....	23
Shtojca 2: Kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi	25
Kriteret e auditimit.....	25
Pyetjet e auditimit	26
Fushëveprimi i auditimit	26
Metodologjia e auditimit.....	26
Shtojca 3: Informatat rreth komunave përfituese	27
Shtojca 4: Letër Konfirmimet	28

Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
DEMOS	Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave
HSIK	Fondacion Zviceran në Kosovë HELVETAS
GPK	Granti i Performancës Komunale
MPL	Ministria e Pushtetit Lokal
OE	Operator Ekonomik
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECO	Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomike
SIDA	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i auditimit “Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale” për vitin 2019, është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (përmes Projektit për Decentralizim dhe Përkrahje Komunale). Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojë nëse shpenzimet dhe menaxhimi i projekteve kapitale të Grantit të Performancës Komunale të bashkëfinancuar nga Fondacioni Zviceran në Kosovë/Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave si dhe Ministria e Pushtetit Lokal, është në harmoni me kërkesat e marrëveshjes dhe nëse këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara.

Qëllimi i përgjithshëm i Grantit të Performancës Komunale është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Për vitin 2019 nga ky Grant kanë përfituar 19 komuna, në vlerë totale prej 2,754,412€. Ne kemi audituar 6 komunat vijuese: Prizren⁵, Glllogoc, Vushtrri, Viti, Shtërpçë dhe Obiliq apo 912,441€ të shumës së grantit. Përzgjedhja e komunave dhe projekteve për auditim është bërë duke marrë parasysh madhësinë e komunës, shumën e ndarë nga ky Grant, numrin dhe llojin projekteve, shtrirjen gjeografike, etj.

Auditimi ka konkluduar që Granti i Performancës Komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat në mënyrë direkte apo indirekte në arritjen e objektivave strategjike dhe ka arritur qëllimin e tij kryesor duke ofruar shërbime më të mira komunale për qytetarët.

Komunat e audituara kanë aplikuar procedurat e prokurimit në fuqi ashtu siç parashihet me kërkesat e këtij Granti duke filluar nga përfshirja e projekteve në planin e prokurimit publik, zhvillimi i procedurave adekuate/të hapura të prokurimit, emërimin e menaxherëve të kontratave sipas kërkesave në fuqi si dhe fondet e ndara janë shpenzuar për projekte kapitale dhe për qëllimin e kontraktuar. Po ashtu, qytetarët në përgjithësi janë të kënaqur me investimet në zonat ku ata banojnë dhe i kanë mirëpritur projektet të cilat kanë sjellë të mira publike. Edhe pse disa projekte janë financuar nga donatori e disa të tjera nga buxheti i vendit, kjo nuk ka paraqitur pengesë në realizimin e projekteve⁶.

Mirëpo, pavarësisht që Granti i Performancës Komunale ka arritur qëllimin e synuar, komunat duhet të përmirësohen në disa aspekte të menaxhimit të këtij Granti.

Komunat ende nuk kanë proces standard të pranimit të kërkesave nga qytetarët, shqyrtimit të tyre dhe prioritizimit të nevojave për investim.

Pesë nga gjashtë komunat e audituara nuk kanë arritur të përfundojnë projektet me kohë. Arsyet e këtyre vonesave ndërliken me inicimin e procedurave të prokurimit me vonesë, mos ofrimin e kushteve të përshtatshme të punës për Operatorët Ekonomik dhe mos përgjegjshmërinë e Operatorëve Ekonomik ndaj kontratës. Po ashtu, ka mangësi në procesin kontraktimit për shkak se shumica e kontratave janë nënshkruar në pjesën e fundit të vitit.

⁵ Komuna e Prizrenit ishte subjekt i auditimit edhe për vitin 2018.

⁶ Grantit i Performancës Komunale është bashkë financuar nga Fondacioni Zviceran në Kosovë/Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave dhe Ministria e Pushtetit Lokal.

Andaj, procesi i menaxhimit të kontratës duhet të monitorohet dhe forcohet më tepër për të maksimizuar rezultatet e synuara.

Vlerësojmë se me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunale, komunat duhet të fillojnë të dokumentojnë formën dhe kriteret e përdorura në prioritizimin e investimeve kapitale, në mënyrë që t'u jepet prioritet atyre projekteve të cilat janë më me interes për qytetarët. Si referenca se si të dokumentohen dhe të poentohen kriteret mund të përdoren udhëzimet e lëshuara nga Ministria e Financave.

Për më tepër, komunat duhet të forcojnë procesin e menaxhimit të këtyre projekteve, duke filluar me inicimin e procedurave të prokurimit me kohë deri te përfundimi i projekteve brenda kohës së kontraktuar. Për këtë qëllim kemi dhënë pesë rekomandime individuale në kapitullin 5.

Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim


Komunat e përfshira në auditim dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna.

1. Hyrje

Qeveria Zvicerane përmes HSIK/DEMOS ka lidhur kontratë me Zyrën Kombëtare të Auditimit që të kryhet ky auditim, për të marrë siguri të arsyeshme se Granti i Performancës Komunale (GPK) është duke i shërbyer qëllimit për të cilin ndahet. Qëllimi i përgjithshëm i GPK-së është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Baza e fillimit të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Zvicrës dhe asaj të Kosovës është në gjithsej shtatë marrëveshje duke përfshirë edhe shtojcat e tyre. Marrëveshja e parë u nënshkrua në vitin 2010, ku pasohet me marrëveshjet tjera të prezantuara në diagramin e më poshtëm, të cilat thellojnë bashkëpunimin ndërmjet dy qeverive duke përfshirë akterët përgjegjës dhe specifikuar procesin dhe mënyrën e menaxhimit të këtij Granti. Në diagramin e më poshtëm janë paraqitë akterët dhe marrëveshjet përkatëse të këtij bashkëpunimi. Detajet e marrëveshjeve janë paraqitë në *shtojcën 1*.

Diagrami 1: Akterët dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Kosovës:



Në vitin 2017, MPL-ja dhe SDC-ja u pajtuan për krijimin dhe financimin e një sistemi gjithë-kombëtar të Grantit të Performancës për Komunale (GPK). Për vitet 2018-2021, GPK-ja ka në dispozicion një buxhet total prej nëntë (9) milionë euro. Ndërsa në vitin 2019, Qeveria Suedeze përmes SIDA (Swedish International Development Cooperation) vendosi që t'i bashkohet këtij Granti me 504,413 euro. Të gjitha komunat (38) e Kosovës gëzojnë të drejtën e aplikimit për këtë Grant.

Përfitues të këtij Granti për vitin 2019 janë 19 komuna me vlerë totale 2,754,412€. Qeveria Zvicerane së bashku me atë Suedeze kanë investuar në 12 komuna: Vushtrri, Istog, Podujevë, Shtime, Skenderaj, Glogoc, Junik, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Pejë, Mitrovicë e Veriut dhe Novobërdë, ndërsa MPL-ja ka investuar në shtatë komuna: Viti, Obiliq, Shtërpçë, Gjiilan, Kaçanik, Lipjan dhe Hani i Elezit.

Përzgjedhja e komunave dhe projekteve për auditim ka përfshirë dy burimet e financimit (MPL dhe SDC)⁷ dhe në bazë të specifikave tjera, sipas analizave dhe gjykimit profesional. Ne kemi audituar 6 komuna: Glogoc, Prizren dhe Vushtrri të financuara nga HSIK/DEMOS në total 671,050€; Obiliq, Shtërpçë dhe Viti në total 241,391€ apo 33% të shumës së Grantit të ndarë.

Motivi i auditimit

Në vitin 2018 është kryer një auditim i performancës nga ZKA-ja për Grantet e Performancës Komunale, fushëveprim i të cilit ishin vetëm projektet e financuara nga HSIK/DEMOS. Për dallim nga viti i kaluar, këtë vit pjesë e auditimit janë edhe grantet e financuara nga MPL-ja.

GPK-ja është e rëndësishme për nga vlera dhe qëllimi. Vlera e ndarë për projektet që do të financohen nga GPK-ja për katër (4) vite është nëntë (9) milion euro, mesatarisht 2,5 milion euro në vit. Në vitin 2019 me hyrjen në bashkëfinancim të SIDA-s, vlera e GPK-së u rrit në 2,75 milion euro. Qëllimi i GPK-së është të kontribuojë në ngritjen e performancës së komunave, andaj auditimi i projekteve të financuara nga GPK-ja ofron mundësi të vlerësojë këtë performancë.

Përderisa GPK-ja është e destinuar për të gjithë qytetarët e komunës përkatëse, ata gëzojnë të drejtën të dinë se ku dhe si janë shpenzuar mjetet e GPK-së. Andaj, ZKA-ja me auditimin e këtyre projekteve synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme për donatorin dhe qytetarët se si po shpenzohen mjetet e GPK-së.

Për më tepër, auditimi për GPK-në e vitit 2018 nxori në pah disa dobësi në procesin e prokurimit duke filluar nga planifikimi, zhvillimi i procedurave dhe menaxhimi i kontratës. Po ashtu, dobësi u identifikuan edhe në prioritizimin e projekteve në të cilat u investua. Këto elemente forcojnë motivin tonë për të vazhduar edhe këtë vit me auditimin e GPK-së.

Objektiva e auditimit dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojë nëse shpenzimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale të financuara nga Granti i Performancës Komunale është në harmoni me kërkesat e marrëveshjes dhe nëse këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara.

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për nivelin komunal dhe palët tjera të interesit në mënyrë që të përmirësojnë menaxhimin e projekteve kapitale të Grantit të Performancës Komunale të bashkë financuar nga HSIK/DEMOS-i dhe MPL-ja, për të përmirësuar qasjen e tyre në raport me donacionet dhe mënyrën e investimeve të tyre.

⁷ Detajet e komunave/projekteve janë paraqitur në shtojcën 2 të këtij Raporti

Pyetjet e auditimit

I. A janë projektet e financuara pjesë e prioriteteve të përcaktuara në strategji/objektiva komunale?

II. A janë menaxhuar projektet në pajtim me kërkesat e marrëveshjes?

1. Investimet e bëra nga mjetet e grantit a ishin vetëm për projektet e aprovuara?
2. Deri në çfarë mase janë respektuar procedurat e prokurimit publik nga komunat?
3. A është bërë procesi i menaxhimit të kontratës sipas kërkesave/kritereve ligjore?

III. A janë arritur rezultatet e pritura përmes granteve të performancës komunale?

1. A kanë përfituar qytetarët nga projektet e realizuara?

Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i vitit 2019 ka përfshirë 6 komuna (Glllogoc, Obiliq, Prizren, Shtërpçë, Viti, dhe Vushtrri) dhe në secilën komunë kemi përshirë nga një projekt.

Tabela 1: Projektet e audituara dhe burimet e financimit të tyre

Komunat	HSIK/DEMOS (€)	MPL (€)	Komuna (€)
Glllogoc	183,439		2,361
Obiliq		74,354	12,916
Prizren	302,096		733,306
Shtërpçë		37,516	4,360
Viti		129,521	83,221
Vushtrri	185,515		105,000
Totali	671,050	241,391	941,164

Përzgjedhja e komunave dhe projekteve për auditim është bazuar në analizat paraprake dhe sipas gjykimit profesional. Jemi bazuar në madhësinë e komunës (nga aspekti territorial dhe numrit të banorëve), shumën e GPK-së të dhënë komunës, shpenzimeve, numrin dhe llojin projekteve, shtrirjen gjeografike, etj.

Periudha kohore përfshinë Grantin e dhënë për vitin 2019. Është audituar procesi që nga kërkesat, përfshirja e projektit në planin e prokurimit, procedurat e tenderimit, dhënia e kontratës dhe deri te pranimi i projektit.


Për informatat rreth komunave përfituese, projekteve në të cilat është investuar dhe metodologjisë së auditimit referohuni tek shtojca 2 dhe 3.

2. Përshkrimi i fushës së auditimit

Granti i Performancës Komunale nënkupton procesin ku komunat përfitojnë mjete financiare në bazë të performancës së tyre në fushat e përzgjedhura. Kushtet minimale që komunat duhet të plotësojnë për t'u kualifikuar që të përfitojnë nga GPK-ja janë: administrimi i shëndoshë financiar dhe shpenzimet të jenë 75% ose më tepër të buxhetit për investimeve kapitale. GPK-ja do të bashkë-financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës (jashtë alokimit buxhetor të MPL-së) dhe SDC-së.

GPK-ja i ndahet komunave në pajtim me pikët e arritura në performancën komunale në bazë të një numri treguesish të fokusuar në tri fusha kryesore: qeverisje demokratike, menaxhim komunal dhe integritet dhe transparencë.

Për shpenzimin e GPK-së, zbatohen rregullat ekzistuese të qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të grantit të përgjithshëm) në aspektin e përdorimit të Grantit, planifikimit të Grantit, si dhe të raportimit dhe llogaridhënies. Komunat përdorin procedurat vendore të tenderimit, kontraktimit, menaxhimit të kontratës dhe pranimit teknik. Komunat mund të përdorin Grantin për investime kapitale sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre, në përputhje me legjislacionin e Kosovës. Rreth procesit të ndarjes së GPK-së, HSIK-ja dhe MPL-ja aplikojnë procedurën e njëjtë e cila është vlerësimi i komunave në bazë të përmbushjes së 27 kriterëve. Ndërsa, sa i përket roleve në menaxhimin e Grantit ka disa ndryshime të cilat janë të prezantuara në grafikun e mëposhtëm:

Grafiku 1: Roli i HSIK/DEMOS, MPL-së dhe komunave në procesin e menaxhimit të GPK-së:

3. Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë paraqitur gjetjet e auditimit të cilat paraqesin aktivitetet e palëve përgjegjëse për t'u siguruar se shpenzimi dhe menaxhimi i projekteve kapitale të financuara nga Granti i Performancës Komunale është në harmoni me kërkesat e marrëveshjes dhe se këto projekte kanë arritur rezultatet e synuara.

Rezultatet audituese janë strukturuar në katër pjesë të ndërlidhura me pyetjet e auditimit:

Pjesa e parë mbulon:

- *Planifikimin e projekteve nga komunat e audituara dhe procesin e prioritizimit të projekteve në të cilat është investuar.*

Kjo pjesë është paraqitur në kapitullin 3.1 e cila ka rezultuar me një gjetje të auditimit.

Pjesa e dytë mbulon:

- *Menaxhimin e projekteve sipas kërkesave të marrëveshjes, aspektet e zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të kontratës dhe pranimit të punëve/mallit..*

Kjo pjesë është paraqitur në kapitullin 3.2 e cila ka rezultuar me dy gjetje.

Pjesa e tretë mbulon:

- *Rezultatet e arritura me anë të këtyre investimeve, sa janë të shfrytëzueshme këto projekte nga qytetarët. Kjo pjesë mbulon intervistimin e përfituesve/ qytetareve të këtyre investimeve dhe nxjerrjen e rezultateve nga këto intervista. Akterët kryesorë edhe në këtë pjesë janë komunat e audituara së bashku me të anketuarit në terren.*

Pjesa e katërt mbulon:

- *Krahasimet e procesit sipas burimeve të financimit të GPK-së nga HSIK/ DEMOS-i dhe MPL-ja.*

Kjo pjesë përfshinë vetëm një pasqyrim të dallimeve në mënyrën e financimit të projekteve nga HSIK/DEMOS-i krahasuar me projektet e MPL-së, andaj në këtë pjesë nuk janë paraqitur gjetje dhe nuk ka rekomandime.

Gjetjet janë paraqitur me numër rendor dhe korrespondojnë me numër të njëjtë të rekomandimeve në kapitullin 5.

3.1. Procesi i prioritizimit të projekteve në të cilat është investuar

Në mënyrë që komuna të ofrojë shërbime të duhura për qytetarët, duhet të sigurohet që objektivat të jenë të vendosura në planet strategjike dhe vjetore, si dhe të jenë të dokumentuara sipas kriterëve dhe kategorive: strategjike, operative, financiare dhe të pajtueshmërisë. Nga gjashtë komunat e audituara, pesë prej tyre nuk kanë kriterë të shkruara të mënyrës së prioritizimit të projekteve për investime kapitale, por secila komunë ka praktikën e saj.

1. Mungesa e dokumentimit të prioritizimit të projekteve

Kemi vërejtur se secila komunë e audituar ka mënyrën e saj të prioritizimit të projekteve dhe nuk e kanë të dokumentuar mjaftueshëm këtë proces, kjo është pohuar/shpjeguar edhe nga zyrtarët përkatës të komunave.

Mungesa e dokumentimit të prioritizimit të projekteve rrjedhë si pasojë e mos ekzistimit të një procedure standarde për përcaktimin/poentimin e peshës së kriterëve për investime kapitale. Mirëpo, pavarësisht që komunat nuk kanë procedurë standarde të definimit të kriterëve në prioritizimin e investimeve kapitale, secila komunë e audituar përdorë dokumente të ndryshme për të pasqyruar projektet, si në vijim:

Komuna e Glllogocit – për prioritizimin e projekteve përdorë strategjinë komunale për investime.

Komuna e Obiliqit – projektet në të cilat investohet janë të bazuara në, strategjinë socio-ekonomike, buxhetin komunal, planin e punës së drejtorisë përkatëse, dëgjimet publike, numrin e banorëve në fshatra/lagje, etj.

Komuna e Prizrenit – vendosë për projektet në të cilat do të investohet bazuar në planifikimet buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale.

Komuna e Vitisë – debatet publike me qytetarët, takimet e kryetarit me qytetarët, plani zhvillimor komunal dhe plani zhvillimor urbanistik.

Komuna e Vushtrrisë – ka investuar në projektin konkret (rikonstruimi i hapësirave publike) pasi që në vitin 2018 komuna ishte ranguar në shkallë të ulët në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale tek ndërtimi i hapësirave publike, andaj kjo është sipas zyrtarëve të komunës arsyeja pse është realizuar pikërisht ky projekt në vitin 2019.

Ndërsa, **Komuna e Shtërpçës** përdorë kriterë të shkruara në rastet e prioritizimit të projekteve kapitale, në fillim të secilit vit përgatitë dy lista të projekteve për investime kapitale, njëra e cila është e hartuar në përputhje me buxhetin komunal dhe lista tjetër e projekteve kapitale hartohet me qëllim të bashkëfinancimit me donatorë. Komuna përdorë një sërë kriteresh të cilat i vendos në matricë ku secili kriter poentohet dhe projekti i cili grumbullon më shumë pikë përzgjidhet për investim. Projektet e parashikuara për bashkëfinancim me donatorët i vendosë edhe në planin e prokurimit.

Ne kemi krahasuar dokumentet e secilës komunë ku i kanë të identifikuar projektet kapitale, për të pasqyruar bazën e investimit për secilin projekt të audituar.

Tabela 1. Projektet e audituara në dokumentet planifikuese të komunave

Komuna	Emri i Projektit	Strategjia komunale për zhvillim	Ligji i Buxhetit	Plani i Prokurimit	Lista e kontratave të nënshkruara
Glllogoc	“Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujerave të zeza në komunën e Drenasit”	Po	Po	Po	Po
Obiliq	Ndriçimi Publik prej shkollës “P.Sotiri - Obiliq i Vjetër deri në kryqëzimin e rrugës Zahir Pajaziti-Kadri Pllana”	Jo	Po	Po	Po
Prizren	“Blerja e pajisjeve mjekësore për nevojat e QKMF-së”	Po	Po	Po	Po
Shtërpcë	“Rregullimi i kanalit dhe trotuarit në Brezovicë - Komuna e Shtërpcës”	Po	Po	Po	Po
Viti	“Rivitalizim i ndërtesës së komunës së Vitisë”	Jo	Po	Po	Po
Vushtrri	“Rekonstruimi i hapësirave publike në sheshe dhe/ose vende të saktësuara në dokumentacionin dhe specifikacionin teknik të ofertës”	Jo	Po	Po	Po

Përveç faktit që pesë (5) komunitat e audituara nuk kanë procedurë standarde të prioritizimit të projekteve kapitale, tri (3) prej tyre nuk i kanë përfshirë projektet e realizuara as në objektivat strategjike. Sipas zyrtarëve në komunitat përkatëse kjo ka ndodhur për arsye në vijim:

Komuna e Obiliqit - në “Strategjinë për Zhvillim Socio Ekonomik Lokal 2017-2021” nuk është planifikuar projekti specifik pasi që të gjitha projektet e parapara në këtë strategji janë përfunduar me buxhet të komunës.

Komuna e Vitisë - “Plani Zhvillimor i Komunës së Vitisë dhe Kllkotit 2010-2020” nuk e ka të paraparë projektin “Rivitalizim i ndërtesës së Komunës së Vitisë”, mirëpo sipas zyrtarëve nevoja për përmirësimin e kushteve të punës në institucionet komunale arsyeton investimin e bërë.

Komuna e Vushtrrisë - nuk kishte dokument strategjik që përfshinë vitin 2019. Plani strategjik i më hershëm ka përfunduar në vitin 2019 dhe plani i ri strategjik nuk është realizuar/hartuar sepse kanë dështuar procedurat e prokurimit për kontraktimin e Operatorit Ekonomik (OE) për të përpiluar strategjinë. Në vitin 2020 është nënshkruar kontrata për hartimin e strategjisë së re.

Mungesa e kritereve të paracaktuara/shkruara për prioritizimin e projekteve kapitale ka ndikuar që komunat e audituara të përdorin praktika të veta që ndonjëherë ndikohen nga rrethanat e momentit se në çfarë të investohet dhe kështu rrezikon që projekti të mos jetë gjithë përfshirës dhe të mos ofrohet mundësia e përfitimit optimal për qytetarët. Mos përfshirja e projekteve në dokumente strategjike ka ndikuar që komunat të investojnë në projekte, planifikimet e të cilave bëhen në baza vjetore dhe si rezultat i kësaj nuk është bërë dokumentimi i vlerësimit real të nevojave në mënyrë që të bëhet përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve në periudhë afatgjate.

3.2. Menaxhimi i projekteve në raport me kërkesat e marrëveshjes

Sipas kërkesave të GPK-së, komunat duhet që Grantin e fituar ta shpenzojnë vetëm për projekte kapitale të aprovuara paraprakisht dhe projektet duhet të përfundojnë brenda vitit 2019. Po ashtu, komunat duhet të respektojnë procedurat e prokurimit publik në Kosovë.

Të gjitha komunat e audituara kanë respektuar procedurat përkatëse të prokurimit publik, mirëpo pesë nga gjashtë projektet e audituara nuk kanë përfunduar me kohë. Pesë projektet që kanë vonesa në realizim, kryesisht janë për arsye të nënshkrimit të kontratave në pjesën e fundit të vitit, mos planifikimit të mirë nga ana e komunave apo mos përgjegjshmërinë e OE-ve ndaj kontratës. Në këto raste, komunat nuk kanë marrë veprimet e duhura dhe si rezultat, qytetarët nuk i kanë përdorë projektet me kohë dhe duke mos penalizuar OE-të nuk kanë kursyer buxhetin e komunës.

2. Projektet në të cilat është investuar ishin aprovuar paraprakisht

Një ndër kushtet minimale që komuna duhet të përmbushë në mënyrë që të jetë përfituese e grantit, është marrëveshja trepalëshe ndërmjet komunës, MPL-së dhe HELVETAS Swiss Intercooperation. Këto marrëveshje janë nënshkruar në pranverën e vitit 2018. Po ashtu, komunat duhet të kenë marrëveshje të bashkëfinancimit të projekteve specifike dhe projektet duhet të jenë të përfshira në Ligjin e Buxhetit të vitit 2019 në mënyrë që investimi të jetë për projekte të aprovuara dhe planifikuara paraprakisht.

Vlerësimi i performancës për komunat është bërë në gusht 2018 dhe në janar të vitit 2019 komunat janë njoftuar për shumën e financimit nga DEMOS-i dhe MPL-ja. Pas këtij njoftimi dhe pajtimi me komunat se cilat projekte do të bashkë financohen, në po të njëjtin muaj janë nënshkruar marrëveshjet specifike për projektet dhe shumat me secilën komunë përfituese të GPK-së. Të gjitha gjashtë komunat e audituara kanë marrëveshjet tri palëshe ku janë të specifikuara projektet në të cilat do të investohet, mirëpo projektet individuale nuk janë të paraqitura si projekte specifike në Ligjin e Buxhetit, por si shtylla të përgjithshme, kjo sipas zyrtarëve ka ndodhur pasi që nuk kishte rishikim të buxhetit për vitin 2019. Kjo rrezikon që projektet të mos jenë të duhurat, mos të arrihen rezultatet e synuara dhe njëkohësisht të ketë mungesë të transparencës se në çfarë projekti synohet të investohet. Andaj projektet mirë të definuara/planifikuara janë të nevojshme me qëllim të realizimit të këtyre projekteve sipas marrëveshjes dhe arritjes së rezultateve.

3. Procedurat e prokurimit publik janë iniciuar me vonesë nga komunat

Sipas rregullave të GPK-së, komunat përfituese duhet të aplikojnë procedurat e prokurimit publik në Kosovë dhe të gjitha projektet në të cilat investohet duhet të përfundohen brenda vitit fiskal 2019. Nga gjashtë komunat e audituara ne kemi identifikuar që të gjitha komunat kanë përdorë në mënyrë të duhur procedurat e prokurimit publik të Kosovës për realizimin e projekteve. Projektet janë përfshirë në planin e prokurimit, janë përdorë procedurat e hapura të prokurimit publik e deri te nënshkrimi dhe menaxhimi i kontratës sipas rregullave në fuqi.

Megjithatë, kishte vonesa në realizimin e kontratave. Vetëm njëra prej komunave ka përfunduar projektin brenda vitit fiskal 2019. Kjo për arsye se pas aprovimit të buxhetit, inicimi i procedurave të prokurimit nga komunat është bërë me vonesë. Edhe pse aprovimi i buxhetit është bërë në shkurt të vitit 2019, kërkesa për iniciimin e procedurave kryesisht ka filluar në maj, por ka edhe prej tyre që kanë filluar në tetor të vitit 2019.

Arsyet e këtyre vonesave ndërlidhen me kërkesat e vonshme nga njësia kërkuese dhe përcaktimit të deklaratave të nevojave në pjesën e dytë të vitit. Kjo për arsye që projektet ishin më të vogla dhe nuk janë trajtuar me prioritet nga zyrtarët. Inicimi i procedurave të prokurimit me vonesë ka ndikuar që pothuajse të gjitha projektet të nënshkruhen në pjesën e fundit të vitit, ku ka kontrata të cilat janë nënshkruar në dhjetor të vitit 2019. Kjo ka ndikuar që pesë nga gjashtë projektet e audituara të mos përfundohen brenda vitit fiskal. Një pasqyrim i datave që nga deklarata e nevojave deri te pranimi teknik i punëve/mallit për komunat e audituara, është paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 2: Datat e procesit të iniciimit të procedurave të prokurimit

Komuna	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve	Nënshkrimi i Kontratës	Përfundimi i Punëve	Pranimi Teknik
Glllogoci	13/09/2019	5/11/2019	90 ditë	29/10/2020
Obiliqi	03/05/2019	20/08/2019	80 ditë (duke përfshirë edhe ditët për punët shtesë)	11/06/2020
Prizreni	16/10/2019	04/12/2019	15 ditë	13/07/2020
Shtërpca	23/05/2019	08/08/2019	07/10/2019	11/11/2019
Vitia	23/04/2019	01/07/2019	31/12/2019	27/05/2020
Vushtrria	24/05/2019	08/08/2019	65 ditë pune	Ne proces

Nga tabela vërehen vonesat, ndër to është edhe Komuna e Prizrenit e cila ishte rreth shtatë (7) muaj me vonesë. Deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve e kishte bërë në tetor, nënshkrimin e kontratës në dhjetor të vitit 2019 dhe rrjedhimisht pranimi i mallit është bërë në korrik të vitit 2020.

4. Mangësi në procesin e realizimit të projekteve kapitale

Sipas Udhëzuesit të prokurimit publik në Kosovë, Autoriteti Kontraktues (AK) duhet të emëroj Menaxherin e Kontratës për projektet që ka investuar në to. Menaxheri duhet të menaxhoj obligimet dhe detyrat e AK-së të specifikuara në kontratë dhe të sigurojë se OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Pranimi i punëve/mallit duhet bërë në përputhje me bazën kontraktuale të projektit. Në gjashtë komunat e audituara procesi i emërimit të menaxherëve është bërë sipas rregullave në fuqi. Menaxherët e kontratave kanë përpiluar planin e menaxhimit të kontratës dhe kanë bërë raporte për aprovim të punëve në terren. Përveç inicimit të procedurave të prokurimit me vonesë, komunat janë përballur edhe me probleme tjera të cilat ndikuan në mos realizimin me kohë të projekteve, siç janë:

Komuna e Drenasit dhe **komuna e Vushtrrisë** kishin probleme pronësore gjatë implementimit të projekteve. E para, kishte probleme pronësore pasi që projekti ka kaluar në një pjesë të pronës private të qytetarit i cili nuk ka lejuar që kolektori i ujërave të zeza të kalojë nëpër tokën e tij, andaj menaxheri i kontratës është detyruar që të vazhdoj projektin nga pika tjetër deri në zgjidhjen e këtij problemi. Ndërsa, komuna e Vushtrrisë kishte probleme pronësore me banorët e fshatit Studime e Poshtme, ku disa qytetarë kanë pohuar që parcela në të cilën ka filluar të ndërtohet projekti është në pronësi të tyre, mirëpo njëkohësisht parcela ishte pronë e komunës pas procesit të komasacionit⁸. Si rrjedhojë, komuna ka vendosë që projektin e këtij fshati ta zhvendosë në fshatin Lum Madh.

Komuna e Vitisë kishte vonesa në përfundim të projektit për arsye se nuk ishte bërë lirimi me kohë i hapësirave të objektit ku janë zhvilluar punimet andaj nuk ishin krijuar kushtet e përshtatshme të punës⁹ për OE-në që të përfundoheshin punët. Për më tepër, projekti ka rezultuar me aneks kontratë për shkak të parashikimeve jo të sakta gjatë planifikimit të projektit.

Në **komunën e Prizrenit** shkaktarë i vonesave në liferim të mallit ishte OE-ja, i cili ka dërguar mallin me vonesë në komunë dhe kjo e fundit nuk ka marrë ndonjë veprim në këtë drejtim. Edhe komuna e **Obiliqit** kishte vonesa në implementimin e projektit për shkak të mos përgjegjshmërisë së OE-së, mirëpo komuna e **Obiliqit** ka aplikuar penalizmin për vonesa ndaj OE-së dhe të njëjtit i është ndalë pjesa e mjeteve për vonesën respektive. Projekti në komunën e **Obiliqit** po ashtu rezultoi me aneks kontratë për shkak të shtimit të metrave të kabllor dhe gypit furnizues, pozicione këto për të cilat është paraqitur nevoja gjatë ekzekutimit të projektit. Mirëpo me një planifikim më të mirë të projektit do të mund të përfshiheshin këto metra shtesë në kontratën bazë.

Mos planifikimi i duhur i projekteve në kuptimin e krijimit të kushteve për OE-të nga ana e AK-ve ka ndikuar në vonesa të implementimit të projekteve, për më tepër ka rrezikuar që komunat të paditen nga OE-të dhe të ketë implikime financiare. Në anën tjetër, mungesa e aplikimit të penalizimeve ndaj OE-ve për mos liferim të mallit me kohë përveç jo efikasitetit ka edhe efekt financiar për komunën.

⁸ Komasacioni është një proces Agroteknik i cili ka filluar të përdoret në komunën e Vushtrrisë në vitet e 80-ta dhe ka pas për qëllim rregullimin e parcelave dhe bashkimin e tyre në një, dy apo tri varësisht nga sipërfaqet, numri i parcelave dhe kushtet teknike.

⁹ Zgjidhja e problemeve pronësore (Komuna e Glllogocit dhe Vushtrrisë), lirimi me kohë i objektit nga zyrtarët (Komuna e Vitisë).

3.3. Granti i Performancës Komunale dhe rezultatet e synuara

Objektiva kryesore e GPK-së është përmirësimi i ofrimit të shërbimeve për qytetarët, prandaj edhe projektet duhen të jenë të qasshme dhe të gatshme për shfrytëzim nga ana e qytetarëve. Granti i Performancës Komunale i ka ndihmuar komunat e audituara që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve të ndryshme komunale për qytetarët si: shfrytëzim racional të tokave të tyre bujqësore, shëtitore dhe ndriçim publik për qytetarët, përmirësim të infrastrukturës rrugore për qytetarët dhe bizneset, specializim i ekipeve të emergjencës në dhënie të ndihmës së parë, përmirësim i kushteve për punonjësit e administratës komunale dhe shfrytëzim i hapësirave publike në fshatra për qëllime socializmi dhe rekreacioni.

Nga gjashtë komunat e audituara, pesë prej tyre kanë përfunduar projektet deri në tetor 2020 dhe të njëjtat janë në shfrytëzim nga qytetarët. Vetëm komuna e Vushtrrisë nuk e ka projektin e përfunduar për arsye të kontestit pronësor. Projektet për nga natyra janë të ndryshme dhe përdoren nga grupe të ndryshme të qytetarëve. Për të matur nivelin e arritjes së rezultateve të pritura nga GPK-ja, konkretisht efektin të qytetarët, përveç analizave tona, ne gjatë ekzaminimit fizik të projekteve kemi intervistuar edhe qytetarët në terren¹⁰.

Të dhënat e paraqitura më poshtë përfshijnë katër komuna (Glllogoci, Obiliqi, Shtërpca dhe Vushtrria) ku qytetarët janë përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve. Rezultatet e nxjerra nga tabelat e më poshtme rrjedhin nga pyetësi i përgatitur për të anketuarit.

Tabelat në vijim tregojnë përgjigjet e të anketuarve:

A ËSHTË KËRKESË E JUAJA SI BANORË TË FSHATIT/LAGJES KY PROJEKT?

Përgjigja	Numri i të anketuarve ¹¹ në katër komuna	Përqindja (%)
Po	5	25
Jo	15	75
Total	20	100

Burim: intervistat me të anketuarit të zhvilluara në dhjetor 2020 dhe janar, shkurt, mars 2021

Nga tabela shohim se 25% e të anketuarve të katër komunave të audituara janë përgjigjur që projekti në të cilin është investuar është kërkesë e tyre, ndërsa 75% e tyre janë përgjigjur që projekti nuk është kërkesë e qytetarëve.

¹⁰ Kemi përpunuar të dhënat me Paketën Statistore për Shkencat Sociale (SPSS e cila është shkurtesa për Paketën Statistore për Shkencat Sociale dhe përdoret nga lloje të ndryshme studiuesish për analiza komplekse të dhënave statistikore. Zhvillimi i intervistave ka ndodhur gjatë kohës së ekzaminimit fizik.

¹¹ Të anketuarit janë: qytetarët, përfaqësues të bizneseve të mëdha dhe të vogla dhe administrator të fshatit/lagjes

SA JENI TË KËNAQUR ME INVESTIMIN E KOMUNËS NË KËTË PROJEKT?

Përgjigja	Numri i të anketuarve në katër komuna	Përqindja (%)
Shumë të kënaqur	9	45
Mesatarisht	8	40
Aspak	3	15
Total	20	100

Burim: intervistat me të anketuarit të zhvilluara në dhjetor 2020 dhe janar, shkurt, mars 2021

Nga tabela me sipër shohim që 45% e të anketuarve/administratorëve të intervistuar janë përgjigjur se janë shumë të kënaqur me investimin nga komuna, 40% e tyre janë mesatarisht të kënaqur dhe 15% e tyre nuk ishin aspak të kënaqur.

Përveç se sa janë të kënaqur qytetarët me projektet e realizuara ne kemi matur edhe shfrytëzimin e projekteve nga ana e tyre dhe tabela vijuese na jep këtë pamje:

SA KENI ARRITUR TA SHFRYTËZONI INVESTIMIN/PROJEKTIN?

Përgjigja	Numri i të anketuarve në katër komuna	Përqindja (%)
Shumë	10	50
Mesatarisht	9	45
Aspak	1	5
Total	20	100

Burim: intervistat me të anketuarit të zhvilluara në dhjetor 2020 dhe janar, shkurt, mars 2021

Rezultatet në tabelën e dytë me të anketuarit/administratorët na tregojnë se 50% e tyre kanë shfrytëzuar shumë projektin e realizuar, 45% e tyre janë deklaruar që projektet po shfrytëzohen mesatarisht dhe vetëm 5% e tyre kanë deklaruar se projektet nuk janë të shfrytëzueshme.

Pyetja tjetër e radhës për të anketuarit në pyetësorë ishte:

SA KA NDIKUAR PROJEKTI NË PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANORËVE?

Përgjigja	Numri i të anketuarve në katër komuna	Përqindja (%)
Shumë	12	60
Mesatarisht	4	20
Aspak	4	20
Total	20	100

Burim: intervistat me të anketuarit të zhvilluara në dhjetor 2020 dhe janar, shkurt, mars 2021

Nga përgjigjet e të anketuarve/administratorëve kemi vërejtur që 60% janë deklaruar që projekti ka ndikuar shumë në përmirësimin e kushteve të tyre dhe projekti ka arritur të sjell të mira publike dhe lehtësim të jetës në bashkësi, 20% janë deklaruar mesatarisht të kënaqur me ndikimin e projektit në përmirësim të kushteve dhe 20% nuk janë aspak të kënaqur.

Nga rezultatet e këtyre anketave, mund të konkludojmë që projektet janë të shfrytëzueshme dhe pjesa dërmuese e qytetarëve janë të kënaqur me to.


Foto 1: Projektet e realizuara për katër komunat e lartë cekura



PROJEKTI NË GLLOGOC



PROJEKTI NË OBILIQ



PROJEKTI NË SHTËRPCË



PROJEKTI NË VUSHTRRI

Në **Prizren** dhe në **Viti** projektet janë të realizuara dhe janë funksionale, mirëpo për dallim nga katër projektet e komunave më lartë, projektet e realizuara nuk janë në shërbim direkt për qytetarët, por janë në shërbim të punonjësve që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët.

Komuna e Prizrenit ka realizuar projektin për blerjen e pajisjeve medicinale për nevojat e Qendrës Emergjente të Mjekësisë Familjare në Prizren me qëllim trajnimin e stafit. Sipas

zyrtarëve përgjegjës, një pjesë e trajnimeve janë mbajtur fillimisht, mirëpo pjesa e dytë e trajnimeve të parapara të mbahen për ekipet e emergjencës nuk janë mbajtur për shkak të pandemisë COVID-19 dhe si pasojë projekti nuk është plotësisht në shfrytëzim.

Figura 1: Pajisjet medicinale për trajnimin e ekipeve të Emergjencës në Komunën e Prizrenit



Komuna e Vitisë ka realizuar projektin “Rivitalizimi i ndërtesës së komunës” me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës për administratën komunale. Komuna ka intervenuar në tre objekte: presidencë, komunë e vjetër dhe sallën e kuvendit komunal. Sipas zyrtarëve përgjegjës, për shkak se kushtet e punës ishin tejet të rënda në objektet e më hershme, ishte e pashmangshme nevoja për intervenim në përmirësimin e kushteve të punës për punëtorët komunal.

Figura 2: Objekti i Komunës së Vitisë gjatë revitalizimit



Figura 3: Objekti i Komunës së Vitisë pas revitalizimit



3.4. Krahasimet ndërmjet burimeve të financimit të GPK-së nga HSIK/DEMOS-i dhe MPL-ja

Në këtë pjesë kemi paraqitur krahasimet ndërmjet financimit të Grantit nga HSIK/DEMOS-i dhe nga MPL-ja. Nga gjashtë projektet e audituara, tri janë të financuara nga DEMOS-i dhe tri nga MPL-ja. Një krahasim i tillë është bërë për të pasqyruar nëse problemet e hasura në menaxhimin e GPK-së varen nga burimi i financimit, dallimet janë si në vijim:

Transferi i fondeve - pasi që bëhet vlerësimi i performancës për vitin përkatës nga HSIK/DEMOS dhe MPL, bëhet edhe ndarja e Grantit dhe dakordohen për ndarjen e komunave në të cilat do të investohet. Për komunat të cilat financohen nga HSIK/DEMOS, transferi bëhet direk në llogari të komunës përmes fondit burimor 61 (Qeveria Zvicerane) dhe të gjitha procedurat, pagesat dhe monitorimet kryhen nga komuna. Sa i përket komunave të cilat financohen nga MPL-ja, mjetet parashihen në Ligjin e Buxhetit vjetor në kodin përkatës të Ministrisë. Ekzekutimin e pagesave e bënë Ministria tek OE-të pas kryerjes/pranimit të punëve në terren.

Realizimi i projekteve - Pavarësisht mënyrës së ndryshme të financimit të projekteve, gjashtë komunat e audituara kanë vonesa në realizimin e projekteve. Mënyra e financimit nuk ka sjellë ndonjë pengesë apo përparësi në realizimin e projekteve.

Pagesat për punët e kryera dhe mallin e pranuar - edhe pse komunat projektet i kishin të financuara nga dy burime të ndryshme të financimit ato ishin të vëmendshme që pagesat e situacioneve të para ti kryenin nga mjetet e donatorëve në mënyrë që obligimet e mbetura mos të barten edhe në vitin vijues.

Menaxhimi i kontratave - menaxhimi i kontratave tek komunat e financuara nga MPL-ja bëhet nga menaxheri i kontratës i caktuar nga ana e komunës dhe organi mbikëqyrës i caktuar nga ministria, ndërsa tek komunat e financuara nga HSIK/DEMOS-i menaxheri i kontratës është vetëm nga komuna. Edhe pse dy praktika të ndryshme të menaxhimit të kontratave, kjo nuk ka ndikuar në ecurinë e implementimit të projekteve.

Aneks kontrata - tek gjashtë komunat e audituara kemi vërejtur se në tre komunat e financuara nga HSIK/DEMOS-i projektet e realizuara nuk kishin aneks kontratë, ndërsa nga tre projektet e financuara nga MPL-ja, dy¹² prej tyre kanë aneks kontrata. Këto dy komuna kanë edhe aneks Marrëveshje Mirëkuptimi me MPL-në për shtimin e mjeteve të financimit për diferencën e shumës së aneks kontratës.

Regjistri i pasurisë - Në komunat e audituara kemi evidentuar se projektet e përfunduara janë regjistruar si pasuri e komunave. Në dy mënyrat e financimit, projektet në fund barten si pasuri të komunave.

12 Komuna e Obiliqit dhe Komuna e Vitisë

4. Konkluzionet

Granti i Performancës Komunale në përgjithësi i ka ndihmuar komunat në arritjen e objektivave strategjike duke ju ofruar qytetarëve shërbime më të mira komunale duke arritur kështu edhe qëllimin e tij kryesorë për të cilin ndahet.

Pavarësisht që GPK-ja ka arritë qëllimin e vet, kërkohet përkushtim i vazhdueshëm nga ana e komunave në përmirësimin e disa aspekteve të menaxhimit të këtij Granti. Sipas analizës sonë, problemet e hasura në procesin e menaxhimit të GPK-së janë të ngjashme pavarësisht nga burimet e financimit të HSIK/DEMOS-it apo MPL-së.

Komunat kryesisht kanë mbajtur dëgjime publike me qytetarët dhe projektet e investuara janë qoftë në strategjitë për investime apo në dokumentet tjera planifikuese. Megjithatë, komunat nuk kanë proces standard të pranimit të kërkesave, shqyrtimit të tyre dhe nuk kanë arritur të dokumentojnë mënyrën e prioritizimit të investimeve në projektet përkatëse.

Mungesa e definimit të qartë të projekteve në objektivat strategjike, ka ndikuar që komunat të investojnë pa pasur kriteret e shkruara dhe vlerësim real të nevojave të komunës se cilat fusha janë me prioritet dhe më me rëndësi për qytetarët. Mungesa e projekteve specifike në planifikimet strategjike dhe buxhetore, ka ndikuar që komunat projektet të orientojnë në lagje/fshatra pa fizibilitet paraprak, gjithashtu qytetarët e komunës janë të pa informuar se në cilat lagje/fshatra do të realizohet projekti.

Komunat e audituara kryesisht kanë nënshkruar kontratat në pjesën e fundit të vitit, gjë që ka ndikuar në mos implementimin me kohë të projekteve. Për më tepër, nga gjashtë komunat e audituara vetëm komuna e Shtërpçës ka përfunduar projektin në vitin 2019. Arsye të mos përfundimit të projekteve ndërlidhen me inicimin e procedurave me vonesë, mos ofrimin e kushteve të përshtatshme për punë për OE-të dhe mos përgjegjshmërinë e OE-ve. Probleme këto që do të mund të evitoheshin nga komunat para fillimit të procedurave.

Sidoqoftë, nga intervistimi i të anketuarve/qytetarëve ka rezultuar që 60% e tyre janë shumë të kënaqur me investimet dhe se projektet kanë arritë të sjellin të mira publike. Andaj konkludimi është se përkundër mangësive të cekura, GPK-ja ka ndihmuar komunat e audituara që të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve të ndryshme komunale për qytetarët.

5. Rekomandimet

Në mënyrë që komunat dhe akterët tjerë relevantë të sigurohen që GPK-ja ka arritur rezultatet e synuara, planifikimi dhe prioritizimi i projekteve të përmirësohet dhe menaxhimi i këtyre projekteve të forcohet, Zyra Kombëtare e Auditimit rekomandon Kryetarët e komunave Glllogoc, Obiliq, Prizren, Shtërpçë, Viti, dhe Vushtrri që:

1. *Të vendosin proces të dokumentuar të prioritizimit të projekteve në të cilat do të investohet. Komunitetet duhet që të përcaktojnë kriteret për prioritizimin e projekteve duke u bazuar në rëndësinë strategjike, vlerësimin ekonomik dhe financiar dhe të bëjnë vlerësimin e gatishmërisë së zbatimit të projektit;*
2. *Palët relevante të menaxhimit të Grantit të Performancës Komunitetore të rishikojnë mundësinë e vlerësimin/definimit më të hershëm të projekteve për financim, me qëllim të analizimit dhe vendosjes së projekteve me kohë krahas planifikimeve buxhetore dhe rrjedhimisht përfundimin e tyre sipas kërkesave të marrëveshjes;*
3. *Komunitetet të fillojnë me iniciimin e realizimit të projekteve dhe procedurave të prokurimit në momentin e aprovimit të kërkesës nga njësi kërkuese dhe të evitohen pengesat e padobishme në procesin e prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës, në mënyrë që të evitohet nënshkrimi i kontratave në pjesën e fundit të vitit;*
4. *Komunitetet të sigurojnë kushte të përshtatshme për Operatorët Ekonomik që me rastin e nënshkrimit të kontratave të punës projektet të fillojnë dhe të realizohen pa pengesa; dhe*
4.1 Menaxherët e projekteve të sigurohen që OE-të përmbushin të gjitha detyrimet kontraktuale dhe në rastet kur të njëjtit nuk i përgjigjen obligimeve të rekomandohen masat juridike të parapara në kontratë.

Shtojca 1: Detajet financiare dhe të kohëzgjatjes së marrëveshjeve për GPK-në

Viti	Marrëveshja	Qëllimi marrëveshjes	Shuma dhe kohëzgjatja e marrëveshjeve
Tetor 2010	Marrëveshja për bashkëpunim teknik dhe financiar - Marrëveshja Kornizë	Marrëveshja është lidhur për qëllime të bashkëpunimit në respektimin e sundimit të ligjit, parimeve demokratike, të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut siç janë paraparë me Deklaratën Universale për të drejta të Njeriut.	
Nëntor 2014	Marrëveshja për Decentralizim dhe mbështetje komunale (DEMOS), faza I	Kjo marrëveshje bazën e ka në Marrëveshjen Kornizë, ku Qeveria e Zvicrës ka ofruar të përkrahë Pushtetin Lokal dhe Decentralizimin në Kosovë përmes programit DEMOS, marrëveshje kjo e cila u përkrah edhe nga MPL.	Kohëzgjatja e programit 01/07/2014-31/12/2017. SCD vë në dispozicion shumën 12,820,000CHF.
Janar 2015	Shtojca e Marrëveshjes për Decentralizim dhe mbështetje komunale (DEMOS), faza I	Me anë të kësaj marrëveshje përfshihet edhe MPL në bashkëfinancim për mbështetje komunale.	
Qershor 2015	Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet HELVETAS dhe MPL	Ky memorandum përfshinë të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira në bashkëfinancim.	Kohëzgjatja 31/12/2017.
Janar 2018	Marrëveshja në mes të MPL-SDC për krijimin dhe financimin e një sistemi gjithë-kombëtar të Grantit të Performancës për komunat. (DEMOS), faza II	Kjo marrëveshje specifikon shumën financiare të ndarë për katër vite 2018-2021 dhe ndarjen e kësaj shume nëpër vite.	Kohëzgjatja deri më 31/12/2021. Shuma e ndarë ndër vite: 2018: EUR 1,796,351 2019: EUR 1,300,000 2020: EUR 650,000 2021: EUR 753,649

Mars 2018	Marrëveshjet tri palëshe me secilën komunë veçmas	Janë marrëveshjet e nënshkruara në mes të MPL - Komuna - Helvetas Swiss Intercooperation në Kosovë të cilat janë lidhë për të krijuar një kornizë për bashkëpunim mes Palëve në lidhje me Grantin e Performancës.	Secila nga 38 komunat ka një marrëveshje të ngjashme, kohëzgjatja e së cilave është deri më 31/12/2021.
Qershor 2019	Rregullat e Grantit të Performancës	Në bazë të këtij dokumenti specifikohen rregullat dhe kriteret për përfitimin e Grantit të Performancës. Rregullat dhe kriteret azhurnohen në secilin vit të ndarjes së Grantit.	Kohëzgjatja 2018-2021. Shuma e planifikuar për tu ndarë: 9 milion euro.

Shtojca 2: Kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi

Kriteret e auditimit¹³

Shpenzimi i fondeve të financuara nga GPK-ja duhet të jetë vetëm për investime kapitale. Këto investime duhet të arrijnë rezultatet e pritura, do të thotë të jenë për qytetarët dhe të jenë investime me prioritet për komunën.

Konkretisht ne do të vlerësojmë nëse:

- Të dhënat, sistemi dhe transaksionet financiare janë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat në fuqi;
- Projektet e financuara janë pjesë e prioritetëve të komunës dhe në përdorim për qytetarët;
- Çështje tjera që dalin ose lidhen me auditimin.

Bazuar në këtë kemi vendosur kriteret vijuese:

Kriteret për pyetjen e parë¹⁴:

- Projekti duhet të jetë në përputhje me GPK-në dhe shpenzimet duhet të jenë ekskluzivisht për projektin e aprovuar fillimisht;
- Projekti duhet të jetë i përfshirë në planin e prokurimit, PIP dhe ligj të buxhetit të Autoritetit Kontraktues për atë vit;
- Procedurat e prokurimit duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në Kosovë;
- Shpenzimet duhet të jenë të mbështetura në mënyrë të duhur me dokumente origjinale; dhe
- Pranimi i punëve/mallit është bërë dhe përdoret në përputhje me kontratën e nënshkruar.

Kriteret për pyetjen e dytë¹⁵:

- Komunitat duhet të përfundojnë këto projekte brenda vitit fiskal 2019 dhe të jenë lehtë të qasshme për përdorim në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga këto projekte;
- Projektet në të cilat është investuar duhet të jenë pjesë e strategjive komunale dhe me prioritet për komunën; dhe
- Projektet duhet të jenë të shfrytëzueshme dhe për të gjithë qytetarët.

13 Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

14 Rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2019; Ligji nr. 04/1-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës

15 Rregullat e GPK-së për vitin fiskal 2019; Strategjitë komunale për vitin 2019; Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Pyetjet e auditimit

I. A janë menaxhuar projektet në pajtim me rregullat/kërkesat e marrëveshjes?

- Investimet e bëra nga mjetet e grantit a ishin vetëm për projektet e aprovuara?
- Deri në çfarë mase janë respektuar procedurat e prokurimit publik nga komunat?
- A është bërë procesi i menaxhimit të kontratës sipas kërkesave/kritereve ligjore?

II. A janë arritur rezultatet e pritura përmes granteve të performancës komunale?

- Projektet e financuara a janë pjesë e prioriteteve të përcaktuara në strategji/objektiva komunale?
- A kanë përfituar qytetarët nga projektet e realizuara?

Fushëveprimi i auditimit

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për nivelin komunal dhe palët tjera të interesit në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e tyre në raport me donacionet dhe mënyrën e investimeve të tyre.

Ne kemi audituar 6 komuna (Prizren, Glllogoc, Vushtrri, Viti, Shtërpcë dhe Obiliq) të cilat në total shumën e ndarë për projekte e kanë 912,441€ dhe në secilën komunë nga një projekt. Përzgjedhja e komunave dhe projekteve për auditim është bazuar në analizat paraprake dhe sipas gjykimit profesional. Jemi bazuar në madhësinë e komunës (nga aspekti territorial dhe numrit të banorëve), shumën e GPK-së të dhënë komunës, shpenzimeve, numrin dhe llojin projekteve, shtrirjen gjeografike, etj. Periudha kohore përfshinë Grantin e dhënë për vitin 2019. Është audituar procesi që nga kërkesat, përfshirja e projektit në planin e prokurimit, procedurat e tenderimit, dhënia e kontratës dhe deri te pranimi i projektit.

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve audituese dhe me qëllim të mbështetjes së konkluzioneve të auditimit ne kemi zbatuar metodologjinë në vijim:

- Analizimi i kornizës ligjore rregulluese, marrëveshjes përkatëse në mes QRK-së, MPL-së dhe SDC-së;
- Analizimi i kërkesave dhe prioriteteve në strategjitë komunale dhe krahasimi i tyre me prioritizimet për investime të komunës;
- Analizimi i dosjeve të prokurimit dhe krahasimi i tyre me procedurat e Prokurimit Publik në fuqi;
- Interoistimi i zyrtarëve përgjegjës rreth procesit të prioritizimit të investimit në projektet konkrete; dhe
- Krahasimi i pagesave me realizueshmërinë e punë.

Shtojca 3: Informatat rreth komunave përfituese

II	Komuna	SDC+SIDA	MPL	Komuna	Totali	Balance		Nr. i projekteve
						Pjesa e mbetur	Shpenzimi	
1	Vushtrri/ Vuçitri	185,515.00 €		105,000.00 €	290,515.00 €	85,329.50 €	100,185.50 €	12
2	Istog/Istok	165,490.00 €		8,628.00 €	174,118.00 €	0.00 €	165,490.00 €	1
3	Podujevë/ Podujevo	199,872.00 €		220,769.00 €	420,641.00 €	0.00 €	199,872.00 €	3
4	Shtime/ Štimlje	103,784.00 €		23,834.64 €	127,618.64 €	0.00 €	103,784.00 €	1
5	Skenderaj/ Skenderaj	141,890.00 €		209,400.00 €	351,290.00 €	0.00 €	141,890.00 €	2
6	Glogovac/ Glogovac	183,439.00 €		2,361.00 €	185,800.00 €	0.00 €	183,439.00 €	1
7	Junik/Junik	44,772.00 €		48,914.50 €	93,686.50 €	0.00 €	44,772.00 €	2
8	Mitrovicë e jugut/Južna Mitrovica	93,681.00 €		115,894.00 €	209,575.00 €	0.00 €	93,681.00 €	1
9	Prizren/ Prizren	302,096.00 €		733,306.00 €	1,035,402.00 €	140,866.00 €	161,230.00 €	3
10	Pejë/Peć	336,112.00 €		114,678.30 €	450,790.30 €	0.00 €	336,112.00 €	10
11	Severna Mitrovica/ Mitrovicë e verit	18,874.00 €		0.00 €	18,859.04 €	0.00 €	18,874.00 €	1
12	Novo Brdo/ Novobërdë	30,332.00 €		9,153.00 €	39,485.00 €	0.00 €	30,332.00 €	2
13	Viti/Vitina		129,521.00 €	83,221.30 €	212,742.30 €	0.00 €	129,521.00 €	1
14	Obiliq/ Obilić		74,354.00 €	12,915.81 €	87,269.81 €	0.00 €	74,354.00 €	1
15	Štrpce/ Shtërpçë		37,516.00 €	4,359.95 €	41,875.95 €	7,946.19 €	29,569.81 €	1
16	Gjilan/ Gnjilane		299,166.00 €	288,191.00 €	587,357.00 €	0.00 €	299,166.00 €	1
17	Kaçanik/ Kačanik		127,643.00 €	142,421.00 €	270,064.00 €	0.00 €	127,643.00 €	1
18	Lipjan/ Lipljan		231,925.00 €	90,474.47 €	322,399.47 €	4,090.76 €	227,834.24 €	1
19	Hani i Elezit/Elez Han		48,430.00 €	130,000.00 €	178,430.00 €	0.00 €	48,430.00 €	1
TOTAL		1,805,857.00 €	948,555.00 €	2,343,521.97 €	5,097,919.01 €	226,195.50 €	1,579,661.50 €	39+7

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E STËRPECË	
LETËR E KONFIRMIMIT	
Për pajtueshmëri me të gjeturat e Auditimit të Përgjithshëm për raportin e madhësisë së performancës "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin fiskal 2019" dhe për implementimin e rekomandimeve.	
Për: Zyrtë Kombëtare të Auditimit	Vendi dhe data: Stërpçe, 30.04.2021
I ndërruar,	
Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:	
<ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrtës Kombëtare të Auditimit "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale" për vitin fiskal 2019 (në tekstin e mbështetur "Raporti"); • pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndërruar koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe • brenda 30 ditëve nga prezantimi i Raportit final, do t'ja dorëtoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përshkajë atolet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre. 	
Kryetari i Komunës 	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E VITËS	
LETËR E KONFIRMIMIT	
Për pajtueshmëri me të gjeturat e Auditimit të Përgjithshëm për raportin e madhësisë së performancës "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin fiskal 2019" dhe për implementimin e rekomandimeve.	
Për: Zyrtë Kombëtare të Auditimit	Vendi dhe data: Vitë, 29.04.2021
I ndërruar,	
Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:	
<ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrtës Kombëtare të Auditimit "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale" për vitin fiskal 2019 (në tekstin e mbështetur "Raporti"); • pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndërruar koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe • brenda 30 ditëve nga prezantimi i Raportit final, do t'ja dorëtoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përshkajë atolet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre. 	
Kryetari i Komunës 	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI	
LETËR E KONFIRMIMIT	
Për pajtueshmëri me të gjeturat e Auditimit të Përgjithshëm për raportin e madhësisë së performancës "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale për vitin fiskal 2019" dhe për implementimin e rekomandimeve.	
Për: Zyrtë Kombëtare të Auditimit	Vendi dhe data: Vushtri 30.04.2021
I ndërruar,	
Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:	
<ul style="list-style-type: none"> • kam pranuar draft raportin e Zyrtës Kombëtare të Auditimit "Projektet e financuara nga Granti i Performancës Komunale" për vitin fiskal 2019 (në tekstin e mbështetur "Raporti"); • pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndërruar koment për përmbajtjen e Raportit, si dhe • brenda 30 ditëve nga prezantimi i Raportit final, do t'ja dorëtoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përshkajë atolet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre. 	
Kryetari i Komunës 	

